



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA E TIRANËS**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot,

Tiranë më: \_\_\_\_\_. \_\_\_\_ 2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentat e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE UNIFORMA DHE VESHJE TË TJERA  
SPECIALE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: 18110000-3,  
18100000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 8,280,283** ( tetë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e  
tetëdhjetë e tre ) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe  
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit  
publik”, autoriteti/enti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelhërimit, Tiranë  
ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe  
kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I mbajtur sot më datë **18.7.2024**, në DPPGJ – Tiranë, në prani të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit  
të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur i  
thjeshtuar », bazuar në nenin 55 të VKM 285 dt. 19.05.2021 si dhe nenit 49 të Ligjit 162/2020 «Per  
Prokurimin Publik» me mjete elektronike, **me afat 30 ditë nga data e lidhjes së kontrates mbi  
sasinë e mallrave të cilat kërkohet të kontraktohen sipas tabelës si më poshtë vijon:**

**SASIA E MALLIT**

NR.	ARTIKULLI	DREJTORIA	Njësi	Sasia/Drejtori	TOTALI sipas artikujve	PERMASAT					
						S	M	L	XL	XXL	4XL
1	Kominoshe	DZHMJGJQ	copë	50	50			20	20	10	
2	Bluze me mëngë të shkrutra	DKL	copë	80	735	1	16	29	19	10	5
		DPQ	copë	200				20	80	100	
		DZHMJGJQ	copë	400			100	50	200	50	
		DTFE	copë	55				30	15	10	
4	Jelek	DKL	copë	80	740	1	16	29	19	10	5
		DPQ	copë	300				80	120	100	
		DZHMJGJQ	copë	300			50	100	150		
		DTFE	copë	60			20	30	10		
5	Kostum Pune Jeshil	DPQ	copë	50	140				15	35	
		DKL	copë	20			1	8	9	2	
		DZHMJGJQ	copë	70				20	50		
6	Pantallona pune jeshile	DPQ	copë	160	160			20	100	40	
7	Pantallona Jeshile për gra	DZHMJGJQ	copë	140	140		20	50	70		
8	Pantallona të zeza dimri	DTFE	copë	26	26		10	9	5	2	
10	Kostum Pune i zi për mekanikë	DKL	copë	10	10		1	4	4	1	
11	Xhup pune 2 në 1	DPQ	copë	45	75				30	15	
		DTFE	copë	30			10	10	6	4	
12	Përparëse	DPQ	copë	130	260			30	100		
		DZHMJGJQ	copë	130			20	50	60		
13	Përparëse Kopshtari	DZHMJGJQ	copë	25	25		5	20			
14	Mushama Shiu	DZHMJGJQ	copë	100	310		10	40	50		
		DPQ	copë	100					30	70	
		DTFE	copë	30				10	20		
		DKL	copë	80		1	16	29	19	10	5
15	Kapele Kopshtari	DZHMJGJQ	copë	100	100			30	70		
16	Kapele të thjeshta	DPQ	copë	200	200			80	80	40	

NR.	ARTIKULLI	DREJTORIA	Njësi	Sasia/Drejtori	TOTALI sipas artikujve	NR.ÇIZME PUNE/ KËPUCË						
						38	39	40	41	42	43	44
1	Çizme	DZHMJGJQ	copë	50	76		15		20	10	5	
		DTFE	copë	26				6	8	5	6	1
2	Këpucë pune	DPQ	copë	135	296		40	25	10		30	30
		DZHMJGJQ	copë	135		40	10	15	25	15	20	10
		DTFE	copë	26				6	8	5	6	1
3	Këpucë me majë metalike	DKL	copë	10	10	1			4	4	1	

## LËVRIMI I MALLIT

- Të gjithë artikujt do të sillen brënda **30 ditëve** pas lidhjes së kontratës në magazinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Rruga 5 Maji, Tiranë, ku do të merren në dorëzim nga një komision i ngritur për marrjen në dorëzim të këtyre artikujve.

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### **1. KOMINOSHE**

Perberja te jete 100% polyester.Pesha e tyre të jetë 245 gr/m<sup>2</sup>. Materiali të jetë 100% antikurrës dhe të ketë mbajtje të mirë të ngjyrës. Materiali të jetë i përbërë nga fije të gjata pambuku të qëndrueshme në formë rrethore, që të mundësojë rezistencë ndaj pushavitjeve dhe përshtatshmëri të mirë me trupin. Sipërfaqja e veshjes të garantojë mbrojtjen nga njollat e përditshme pa e ndryshuar qëndrueshmërinë dhe rehatinë e materialit. Kominoshet të jenë të llojit trup pa mëngë, me dy pjesë të përparme dhe të pasme. Të ketë 4 xhepa gjithsej. Një xhep në kraharor me zinxhir, dy xhepa ballor në pjesën e pantallonave, dy xhepa në pjesën mbrapa pantallonave.

Kominoshe e punes me rripa e përbere nga material 100% Poliester ,pesha 245gr/m<sup>2</sup>. Ngjyra jeshile e erret pjesa e bustit deri te gjuri dhe jeshile floreshente pjesa poshte gjurit, te jete e ngrohte, higjenikisht shume e paster .

- Pelhure shume rezistente me mbrojtje ekselente nga c'ngjyrosja
- Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV
- 4 xhepa per hapsire mbajtese me te madhe
- Xhep telefoni
- Pjesa mbrapa me llastik
- Te gjithë tegelat me qepje te forte dhe me suzator nga brenda
- Mbrojtese zinxhiri
- Ngjyra jeshile kode pantone CMYK 362 dhe jeshile floreshente kode PMS 380

Artikulli duhet të jetë sipas **Standarteve SSH EN ISO 343:2019 CLASS 3-1 ose ekuivalente**.

### **2 . Bluzë me mençe të shkurtra.** Perberja 55% pambuk 45% poliester, pesha 170 gm<sup>2</sup> ±10.

Polo teknike me mëngë të shkurtra me shikueshmëri të lartë. · Jaka dhe mençet me thurje 1x1 me ngjyre jeshile me te njejen ngjyre te pjeses poshte gjoksit, dhe siper gjoksit ngjyre e jeshile fosforeshente. · jaka me hapje pllakë me 3 kopsa me kontrast. Dy shirita fosforeshent të segmentuar me ngjitje me shikueshmëri të lartë në pjesën e poshte gjoksit. · Pëlhurë e rehatshme e përzier në poliester dhe pambuk për më shumë rehati,

Ne bluze do të jetë e stampuar logo e bashkisë si dhe emri I Drejtorisë. Ngjyra jeshile kode pantone CMYK 362 dhe jeshile floreshente kode PMS 380

### **Certifikimi SSH CE sipas standardeve të mëposhtme: SSH EN ISO 13688:2013/A1:2021 EN ISO 20471:2013/A1:2017 Klasa I /ekuivalente**

**3 . Jelek pune me logo**, me zinxhir, me shirita fosforishente. Ngjyrë jeshile materiali i jelekut duhet të jetë 100% polyester , Jeleku ka të stampuar në shpinë dhe në pjesën e përparme në krahun e majtë Logon sipas modelit bashkangjitur. Te lahet në lavatrice. Të jetë me dy shirita horizontal dhe vertikal reflektues. Të mbyllet me zinxhirë. Logoja në zonën e mbrapme të jelekut Në anën e majtë të pjesës së përparme të jelekut duhet të vendoset logoja e Drejtorisë.

Veçoritë

- Peshe e Lehte
- Shirit reflektues për me shume dukshmeri
- Prerje e bollshme për komfort të shtuar
- **Certifikuar sipas to SSH/EN ISO 20471 ose ekuivalente**
- Certifikim CE
- Materialet:
- Pëlhura: 100% Poliestër, Thurje e endur 125gm2

#### **4. Kostum pune ngjyra jeshile. (Pantallona + xhakete)**

**Pantallona** me dukshmeri te larte, 35% pambuk 65% polyester  $\pm 5\%$  , pesha 245gr/m2  $\pm 10$ . Ngjyre jeshile e erret pjesa deri te gjuri dhe verdhe floreshente pjesa poshte gjurit, xhepa perpara te pjerret dhe 1 xhep me kapak ne pjesen e siper gjurit ne anen e majte, dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, 1 xhep ne pjesen pas, me bel me llastik me mundesi pershtatjeje, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune.

**Xhaketa** me dukshmeri te larte, 35% pambuk 65% polyester  $\pm 5\%$  , pesha 245 gr/m2  $\pm 10$ . Ngjyre jeshile e erret pjesa e gjoksit shpines dhe e verdhe floreshente pjesa poshte, 2 xhepa perpara pllake me kapak dhe 2 xhepa siper me kapak te gjere dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune, Me logo te institucionit.

Standartet **SSH EN ISO 20471 Class: 3/ekuivalente,**  
**SSH EN ISO 13688 / ekuivalente**

#### **5. Pantallona pune jeshile.**

**Pantallona** me dukshmeri te larte, 35% pambuk 65% polyester  $\pm 5\%$  , pesha 245gr/m2  $\pm 10$ . Ngjyre jeshile e erret pjesa deri te gjuri dhe verdhe floreshente pjesa poshte gjurit, xhepa perpara te pjerret dhe 1 xhep me kapak ne pjesen e siper gjurit ne anen e majte, dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, 1 xhep ne pjesen pas, me bel me llastik me mundesi pershtatjeje, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune.

**Standartet: SSH EN ISO 20471 Class: 2, SSH EN ISO 13688 / ekuivalente**

## **6. Pantallona pune jeshile per gra.**

**Pantallona** me dukshmeri te larte, 35% pambuk 65% polyester  $\pm 5\%$  , pesha 245gr/m<sup>2</sup>  $\pm 10$ . Ngjyre jeshile e erret pjesa deri te gjuri dhe verdhe floreshente pjesa poshte gjurit, xhepa perpara te pjerret dhe 1 xhep me kapak ne pjesen e siper gjurit ne anen e majte, dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, 1 xhep ne pjesen pas, me bel me llasik me mundesi pershtatjeje, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune.

**Standartet: SSH EN ISO 20471 Class: 2; SSH EN ISO 13688 / ekuivalente**

## **7. Pantallona te zeza dimri**

Perberja: 65% Poliestër, 35% Pambuk  $\pm 5\%$  . Pesha: 245 gr/m<sup>2</sup>  $\pm 10$ . Materiali duhet të jetë anti-tkurrës, të mbajë shumë mirë ngjyrën. Pëlhura duhet të jetë e përbërë me fije pambuku të gjata të qëndrueshme në formë rrethore, për të mos krijuar pushavitje. Pantallonat duhet të ketë 5 xhepa për hapsirë mbajtëse më të madhe, 1 xhep të madh anësorë, dy xhepa mbrapa ku një xhep të jetë me kapak, dy xhepa përpara si dhe një xhep të vogël për monedha në krahe. Xhepat anësore të ketë një xhep hapje mbyllje me grifshë por më shpejtë. Të gjitha pikat e dobëta të qepjeve të jenë të përforcuara. Në pjesën e përparme mbërthimi të bëhet me zinxhirë. Brezi i pantallonit ka të fiksuar yliqe (hallka për kalimin) për vendosjen e rripit. Kopsat të jenë ngjyrë si tekstili ose të errëta.

**Standartet: SSH EN ISO 20471 Class: 2 ; SSH EN ISO 13688 / ekuivalente**

## **8. Kostum pune per mekanik (Xhakete+pantallona)**

**Kominoshet (pantallonat** të përbëhen nga 65% poliestër dhe 35% pambuk  $\pm 5\%$  . Pesha e tyre të jetë 245 gr/m<sup>2</sup>. Materiali të jetë 100% antikurrës dhe të ketë mbajtje të mirë të ngjyrës. Materiali të jetë i përbërë nga fije të gjata pambuku të qëndrueshme në formë rrethore, që të mundësojë rezistencë ndaj pushavitjeve dhe përshtatshmëri të mirë me trupin. Sipërfaqja e veshjes të garantojë mbrojtjen nga njollat e përditshme pa e ndryshuar qëndrueshmërinë dhe rehatinë e materialit. Kominoshet të jenë të llojit trup pa mëngë, me dy pjesë të përparme dhe të pasme. Të ketë 4 xhepa gjithsej. Një xhep në krahator me zinxhir, dy xhepa ballor në pjesën e pantallonave, dy xhepa në pjesën mbrapa pantallonave.

Kominoshe e punes me rripa e përbere nga material 65% Poliester dhe 35% Pambuk  $\pm 5\%$  , pesha 245gr/m<sup>2</sup>. Ngjyra gri e erret ose i zi pjesa poshte gjurit, te jete e ngrohte, higjenikisht shume e paster .

- Pelhure shume rezistente me mbrojtje ekselente nga c'\ngjyrosja
- Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV
- 4 xhepa per hapsire mbajtese me te madhe
- Xhep telefoni
- Pjesa mbrapa me llastik
- Te gjithë tegelat me qepje te forte dhe me suzator nga brenda
- Mbrojtese zinxhiri

**Xhaketa** 35% pambuk 65% polyester  $\pm 5\%$ , pesha 245gr/m<sup>2</sup>  $\pm 10$ . Ngjyra gri e erret ose I zi, pjesa e gjoksit dhe shpines ku ndahet me gjysmen e pjeses poshte eshte e perbere me nje

fileto kordon fosforeshent gri gjeresi 0.5 mm ne gjithe perimetrin e saj. Pjesa poshte, 2 xhepa te pjerret perpara me fileto dhe astar, Dy xhepa siper me kapak, te gjere sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune. Mbyllja perpara me zinxhir te fshehur ne patiletë me gjeri 5-8 cm e perbere me 3 butona/velkrofe. Pjesa fundore e xhaketes e perbere me qemer 5-8 cm ne forme xhiboksi. Menget te perbera nga nje çarje dhe me manshete me gjeresi 5-8 cm e rregullueshme dhe me velkrof. Me logo te institucionit.

**9. Xhup pune 2 ne 1** me logo to AK ngjyra jeshile floreshente kode PMS 380. Materiali i xhupit duhet të jetë 100% polyester dhe brenda duhet të jetë me mbushje me vatine. 100% polyester, xhup ngjyrë jeshile me 1 shirit fosforeshente horizontal.

Veçoritë

- Qepje me Shirit Hermetik për të ndaluar penetrimin e ujit
- Siperfaqja e pëlhurës është ekstremisht uje rezistuese, duke e shperndare nga superfaqja e pëlhurës.
- SSH EN 342 Mbrojtje ndaj të ftohtit e çertifikuar deri në -40°C
- Menge e brendshme të Trikotuar
- Me Shtresë dhe mbushje të plote për të mbajtur ngrohtësinë e trupit
- Menge të rregullueshme Hook & loop
- Zinxhir i Dyanshem për Hapje të Shpejte
- Shirit Bio motion pattern (lloji I shiritit fosforeshent te segmentuar me dukshmeri ne distance te laget) për të permiresuar dallimin e formes njerezore ne distance.
- Certifikuar sipas:
- SSH/EN ISO 20471/ ekuivalente pas 50x larjeve - Veshje me shikueshmëri të lartë.
- SSH/EN 343/ekuivalente Klasi 3:1 X (WP 15,000 mm) - mbrojtja nga moti i lagësht, mjegulla dhe lagështia.
- Pëlhurë e klasifikuar me UPF 40+ për të bllokuar 98% rrezeve UV
- 2 xhepa pllake ne pjesen para me dy menyra hapje, nga siper me kapak dhe nga anash, për vendosje të sigurte. Pjesa rreth gjoksit dhe shpines ngyre jeshile floreshente dhe pjesa poshte dhe menget jeshile ose blu e erret, e perber nga shirit fosforeshent te segmentuar me ngjitje, menget te cmontueshem me zinxhir. Kapuç që paloset nen jake
- Certifikim SSH/CE ekuivalente
- Materialet:
- Pëlhura Jashtme/Kryesore: 300D Industria: 100% Poliestër, Thurje Oxford 300D, e Veshur me Dopje PU, me Sipërfaqe Anti-Njollave 190gm2

Materiali vatines: 100% Poliestër, 170 gr/m2

Astari: 100% Poliestër, 60gm2

**STANDARTET;**

**SSH EN ISO 20471/ ekuivalente Klasi 3 - veshje me shikueshmëri të lartë.**

**SSH EN 343/ ekuivalente Klasi 3:1 X (WP 15,000 mm) - mbrojtja nga moti i lagësht, mjegulla dhe lagështia.**

**SSH EN 342 (0,345 (M<sup>2</sup>.K/W), 2, X) / ekuivalente - Veshje mbrojtëse – mbrojtje nga të ftohtit.**

**Të jenë konform standartit europiane SSH EN 343:2019/ ekuivalente Veshje mbrojtëse - Mbrojtja nga shiu klasi 3 / SSH EN ISO 13688:2013/A1:2021/ ekuivalente Veshje mbrojtëse - Kërkesa të përgjithshme - Amendamenti 1 (ISO 13688:2013/Amd 1:2021) / SSH EN ISO 20471:2013/A1:2016 / ekuivalente Veshje me dukshmëri (largësi shikimi) të**

**lartë - Metoda prove dhe kërkesat - Amendamenti 1 (ISO 20471:2013/Amd 1:2016) / ekuivalente ose ekuivalente sipas Direktivës 2016/425.**

## **10. Përparëse standarte pune**

Përparëse me mbyllje të përparme me kopsa, dy xhepa në pjesën e përparme dhe një xhep në pjesën sipër. Ruajtje ndaj daljes së bojës dhe rrudhosjes. Në pjesën e pasme të saj do të stampohet logo sipas të dhënave të AK. Me mëngë të gjata ose të shkurtra sipas të dhënave të AK. Ngjyra jeshile e nderthurur me të jeshile floreshente, ku pjesën e rrethgjoksit dhe gjysem krahut të jetë një ngjyra jeshile floreshente dhe pjesa tjetër ngjyra jeshile.

- Pelhure shume rezistente me mbrojtje ekselente nga c'ngjyrosja
- Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ për të bllokuar 98% rrezeve UV
- 3 xhepa për hapsirë mbajtëse me të madhe
- Të gjithë tegelat me qepje të forte dhe me suzator nga brenda
- Mberthimi para me kopsa ose butona
- Ngjyra jeshile kode pantone CMYK 362 dhe jeshile floreshente kode PMS 380

Pelhure kryesore: - 65% Poliester, 35% Pambuk  $\pm 5$  %. Pesha: 245 gr/m<sup>2</sup>  $\pm 10$

## **11. Perparese kopshtari**

Perparese tip peranzine material xhins 100% pambuk, pesha 320 gm<sup>2</sup>, e perber me dy ose tre xhepa për vendosje sendesh, me rrip për në qafe dhe dy rripa për në mes, perparesja duhet të jetë e perbere dhe me dopio cope në pjesën e barkut material pvc.

## **12. Mushama shiu.**

Të jetë materiali plastik (me përbërje 100% poliestër e veshur me PVC), për kushte të lagështa, me kapuc. Ngjyra jeshile. Gjatësia deri në kupë të gjurit. Me xhepa të mëdhenj dhe material që ventilohet. Pelerine shiu me shirita reflektive duke përdorur pëlhurë të lehtë, kjo pelerinë është plotësisht i papërshkueshëm nga uji, gjithashtu përmban një kapuç të ambalazhuar, xhepa për ruajtje të sigurt, si dhe unaza dhe carje shpinën e pasme për të shtuar ajrosjen.

- Pëlhurë e lehtë ujëduruese me qepje të izoluar për të ndaluar penetrimin e ujit
  - Qepje hermetike me shirit për mbrojtje më të madhe
  - Shirit reflektues për më shumë dukshmëri
  - Hapje me zinxhire para
  - 2 xhepa për hapsirë të sigurtë
  - Kapuç që paloset nën jakë
  - Mëngë elastike nga brenda
  - Vrima dhe hapje mbrapa për ventilim dhe rehati
  - Sipërfaqja e pëlhurës është ekstremisht ujë resistuese, duke e shpërndarë ujin nga sipërfaqja e pëlhurës.
  - Të ketë logot e autoritetit para majtas, në shpinë dhe mëngën e majtë.
- Përmbajtja 100% Poliestër, e Veshur me PVC 210g  
Ngjyra/Fit/Size blu e errët/ jeshile erret Nr. S - 3XL

Artikulli duhet të jetë sipas **Standarteve SSH EN ISO 343:2019 CLASS 3-1 ose ekuivalente**

### **13. Kapele kopshtari**

Konfigurimi në pjesën e jashtme të saj me material ngjitës reflektiv krijon mundësinë e një pamje vizuale me të qartë dhe gjatë punimit natën. Në pjesën ballore të kapeles të jetë e shënuar logo e Institucionit me të njëjtin material ngjitës reflektiv. Në pjesën ballore të helmetës do të jetë mbrojtësja me material të tejdukshëm dhe rezistent nga goditjet, duke mbuluar fytyrën deri në fund të mjekrrës. Ngjyra dhe dizajni i logos do të jenë sipas modelit të prezantuar nga autoriteti kontraktor.

### **14. Kapele të thjeshta**

E plotë me strehë ngjyrë jeshile me logo sipas kërkesës të AK. Kapele e plotë me strehë e pajisur me mbyllje plastike. Ngjyra jeshile. KODE PANTONE 361

Lenda e parë: Dok Perberja: 65% poliestër ,35% pambuk me rrjete antistatike

Ngjyra: jeshile

Masa: 205g/m<sup>2</sup> ± 5

Thurja: 2x1 diagonal

### **Ne përputhje me EN1149-3/ ekuivalente**

Kapelja tip sport. Permasat dhe përgatitja e kapeles. Proçesi i montimit dhe qepjes së strehës së kapeles tip sport kryhet në makina speciale qepjeje. Materialet të cilat duhen të përdoren për ndertimin e kapeles janë: \* kollaritje që është material tekstili ngjites për të forcuar pjesët e kapeles \* syze plastike me ngjyrë të gri për ajrim \* fiksues shirit plastik ngjyrë të errët me 6 pozicione \* forcuar për në brendësi të strehës material flete PVC e presuar me trashësi 1.5–2 mm Kapelja përbehet nga kupa (pjesa e sipërme), fiksuesja dhe strelha. Kupa duhet të jetë e ndarë në 6 pjesë. Pjesët nga ana e brendshme duhet të jenë të kollaritura.

### **15. Cizme Pune, ngjyra e zezë/jeshile.**

Mbushje e brendshme me poliester të bardhë. Të ketë 3 shiritat me volum në të dyja anët në pjesën e sipërme për lehtësi veshjeje, rezistentë ndaj vajrave. Materiali PVC; PVC nitrile; Rezistente ndaj nxejtësisë; Rezistente ndaj rrëshqitjes. Cizme poshtë gjurit prodhuar me PVC tubolare.

Të dhënat e prodhuesit dhe standartet e mbrojtjes që ofron duhet të përmbajne:

Certifikim CE sipas rregullores Europiane 2016/425 standarti për **SSH EN ISO 20344:2021/ekuivalente**. Pajisje mbrojtëse personale- Metodën e provës për këpucët (**ISO 20344:2011**) ose ekuivalente.

**16. Këpucë Pune** e cila mbron nga ngjeshja me një forcë deri në 15 kN ose një ngarkesë që peshon deri në 20 kg të padepërtueshme nga lagështia, me ngjyrë të zezë me qepje rezistente gri. Pjesa e sipërme e këpucëve është prej lëkure natyrale të ndarë dhe veshja e brendshme prej polistri.



Këpucët duhet të jenë të certifikuara sipas standartit SSH/EN ISO 20345:2011/ekuivalent. Shollë gome kompakte e presuar me element dizanjo për mosrreshqitje. Goma kundra vajrave, produkte të naftës, etj

- Fundi (sholla) të jetë me gomë kompakte.
- Bombeja (maja ku Këpucë takojnë gishtërinjtë) dhe forteja (pjesa e thembrës), të ketë majë jo metalike
- Sholla e gomës të jetë kompakte e dhëmbëzuar. Të ngjitet me tabanin, fjapen me faqet me ngjitës me dy komponente.
- **Të jenë konform standartit europiane, SSH EN ISO 20345:2011/ ekuivalent Pajisje mbrojtëse personale - Metodat e provës për këpucë sigurie (ISO 20345:2011)/ekuivalent vlefshme për këpucët e sigurisë dhe profesionale (ose ekuivalente) sipas Directives 2016/425**

**17. Këpucë Pune me maje metalike** e cila mbron nga ngjeshja me një forcë deri në 15 kN ose një ngarkesë që peshon deri në 20 kg të padepërtueshme nga lagështia, me ngjyrë të zezë me qepje rezistente gri. Pjesa e sipërme e këpucëve është prej lëkure natyrale të ndarë dhe veshja e brendshme prej polistri.

Këpucët duhet të jenë të certifikuara sipas standartit **SSH/EN ISO 20345:201/ ekuivalent** me nivel mbrojtje S1+SRC+P

- Shollë gome kompakte e presuar me element dizanjo për mosrreshqitje. Goma kundra vajrave, produkte të naftës, etj
- Fundi (sholla) të jetë me gomë kompakte.
- Bombeja (maja ku Këpucë takojnë gishtërinjtë) dhe forteja (pjesa e thembrës), të ketë majë Celiku/Composite për mbrojtjen e gishtërinjve nga goditjet deri në 200 joules dhe shtypje deri në 15kN.
- Sholla e gomës të jetë kompakte e dhëmbëzuar. Të ngjitet me tabanin, fjapen me faqet me ngjitës me dy komponente.

**Të jenë konform standartit europiane, SSH EN ISO 20345:2011/ekuivalent Pajisje mbrojtëse personale - Metodat e provës për këpucë sigurie (ISO 20345:2011)/ ekuivalent vlefshme për këpucët e sigurisë dhe profesionale (ose ekuivalente) sipas Directives 2016/425**

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur tek grupi i punes i ngritur per hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve te vecanta teknike, te procedures ne reference.

Gjithashtu NJP eshte bazuar në nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e nevojave, specifikimeve teknike, fond limit dhe kriterëve të vecanta teknike me miratimin e titullarit te AK .

*Data e hapjes së ofertave planifikuar date 29.07.2024 Ora: 11:00*

- [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

- *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.*
- *Dokumentat pa pagesë.*

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën perkatëse të DST –ve, kriteret, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuara nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

***Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , janë argumentuar nga grupi i punës i ngritur me Urdher Nr. 451 prot date 09.02.2024 specialistet e fushes nisur nga natyra dhe përmasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:***

---

## **I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2021,2022,2023) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se **40 % e vlerës së parashikuar te kontrates.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 1 dhe 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

---

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve te fundit ushtrimore (2021,2022,2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesëmarrjen, për të rritur konkurrencën dhe gjithëpërfshirjen, njësi ka kërkuar që paraqitet deklarata për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gryojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet

tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

*"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh:***
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh:***
- iii) *iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël".*

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit**, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

---

**Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes i ngritur me Urdher Nr. 451 prot date 09.02.2024 specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:**

---

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në vlerën jo më e vogël se **20 % e vlerës së perlllogaritur të kontrates.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që përvorët të ngjashme per procedurat e thjeshtuara të jenë ne vlerën jo me e vogel se 20 % të vlerës se **perllogaritur te kontrates**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

---

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet te dokumentojë se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve eshte sipas standartit **ISO 9001 – 2015/ekuivalente** dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet te paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015/ekuivalente të Prodhuesit.

**Argumentim:** Kërkesa e cilësisë të përcaktuar është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

*akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

---

**2.3.3** Ofertuesi duhet të deklarojë nëse është prodhues i artikujve ose tregtues i autorizuar nga prodhuesit e artikujve/furnizuesve të autorizuar, për këtë objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues i artikujve, duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ku të vërtetohet lidhja midis tij dhe prodhuesit/furnizuesit. Dokumenti provues për këtë objekt prokurimi, duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: website, e-mail, telefon, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentim:** Ne baze të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe pikën 8 të nenit 40 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kerkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohsisht edhe me treguesit cilësor të mallrave që kerkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standartet. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësi teknike. Kjo kerkese i shërben AK për njohjen e mundësive të OE për përmbushje me sukses të kontratës.

**2.3.4** Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë **OEKO-TEX për tekstilet klasi II, aneks IV (ose ekuivalente me to)**, të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter është i nevojshëm që OE për të gjithë artikujt e kërkuar të tekstilit të jenë të përshtatshëm dhe me certifikim standart, duke filluar nga fijet në pëlhurat e përfunduara dhe artikujt e përfunduar. Kjo përfshin fijet, butonat, zinxhirët dhe veshjet. Çdo artikull tekstili të mbajë etiketën standart, të jenë të sigurt dhe testuar për substanca të dëmshme si dhe artikulli është i padëmshëm në aspektin ekologjik njëzërisht, pa substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut. Oeko tex certificate është një certifikim për produktet e tekstilit edhe lekures që verifikon sigurinë e tyre kimike. Oeko tex është kodi i shoqatës ndërkombëtare për kërkim edhe testim në fushën e tekstileve edhe lekures. Ky lloj certifikimi teston artikujt për një sërë kimikatesh edhe certifikon ato nëse janë të sigurta për përdorim. Kur një produkt ka CERTIFIKIM OEKO TEX do të thotë që çdo komponent i produktit- duke përfshirë kopsat, butonat, astatet, frazelinat, penjtë, zinxhoret, zburimet, aksesoret janë testuar kundrejt një liste të gjatë të substancave të dëmshme dhe janë gjetur të sigurta për shëndetin njëzërisht. Për këtë arsye kërkohet që produktet në teresi jo vetëm lenda e parë të jenë të certifikuara me OEKO TEX.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet te paraqese ditën dhe orën e hapjes së ofertave nga një mostër për çdo artikull objekt prokurimi, në përputhje me të gjitha specifikimet e kërkuara në DT. Dorëzimi i mostrave, do të bëhet pranë 'Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit', Rruga 5 Maji, Tiranë. Monstrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë I cili duhet të përmbajë të dhenat:

- Monster
- Emri i artikullit,
- Data e zhvillimit të tenderit,
- Emrin e prodhuesit/ofertuesit,
- Nënshkrimi dhe vula e Operatorit Ekonomik.

Nese ka mungese monstrash për artikujt e kërkuar, atëherë oferta duhet të quhet jo e rregullt dhe për pasojë ofertuesi duhet të skualifikohet. gjithashtu mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përben shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nënën 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar monstrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, ato janë përzgjedhur për artikujt që kanë sasi të konsiderueshme të cilët janë më të kërkuarit. Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton: "...KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa prej produkteve objekt prokurimi..." Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar monstrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike.

**(Shënim:** Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

**2.3.6 Operatori ekonomik** ofertues duhet të paraqese skeda teknike/katalog për produktet e ofruara ku të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara (Në rastet e bashkimit të operatoreve

ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te dorezoje dokumentet e mesiperme te kriterëve te vecanta ne perpjestim me perqindjen e marre persiper ne aktin e krijimit)

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara

Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

E gjykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie , certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kerkesave dhe garanton Autoritetin Kontraktor per cilesine dhe standartet e larta nderkombetare dhe te perditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

*Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.*



## **Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:**

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) *çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. ***Lidhur me këtë proces, grupi i punës pas përgjigjes së INSTAT -it në te cilën shprehen se nuk disponojnë listë cmimesh per “Blerje Uniforma dhe veshje te tjera sepeciale” nepermjet e-mail zyrtar, ka argumentuar dhe dokumentuar bazuar pikes 1 germa “b” te nenit 76 te ligjit 162/2020 konkretisht:***

- ***Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.***

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Theksojmë se 'Specifikimet Teknike' i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.*

*Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punës referuar praktikës miratim të titullarit të AK me Nr.451/5 prot. dt. 05.04.2024, miratuar nga titullari i AK, bazuar në parashikimet e nenit 36 dhe nenit 77 të Ligjit 162/2020 dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

**Afati i shërbimit: Sipas nevojave dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor për 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.**

*Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.*

*Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*